



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 22

Tiranë – E hënë, 4 gusht 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 392/4, datë 24.7.2025	Për procedurën konkurruese “Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i stadiumit ‘Skënderbeu’ Korçë dhe rikualifikimi i zonës përreth”.....	3
Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 393/4, datë 24.7.2025	Për procedurën konkurruese “Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i stadiumit ‘Flamurtari’ Vlorë, rindërtimit/rikonceptimit të pishinës dhe të pallatit të sportit, si dhe rikualifikimit të zonës përreth”.....	6
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 375, datë 29.7.2025	Për njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.....	10



NJOFTIM

Nr. 392/4, datë 24.7.2025

**PËR PROCEDURËN KONKURRUESE
“ZHVILLIMI NËPËRMJET
SIPËRMARRJES I STADIUMIT
‘SKËNDERBEU’ KORÇË DHE
RIKUALIFIKIMI I ZONËS PËRRETH”**

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit të Investimit:	Rijetëzimi i stadiumit “Skënderbeu” Korçë dhe rikualifikimi i zonës përreth
Titulli i kontratës:	Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i stadiumit “Skënderbeu” Korçë dhe rikualifikimi i zonës përreth

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata zhvillon projektin e investimit “Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore”, pjesë e të cilit është nënprojekti “Rijetëzimi i stadiumit ‘Skënderbeu’ Korçë, dhe rikualifikimi i zonës përreth” (këtu “Projekti”), nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes lidhur me disa prona publike të cilat do të jepen për zhvillim, të përcaktuara në seksionin IV, nënseksioni 2, “Informacioni për pronën”, të “Dokumentit të kualifikimit”.

3. Projekti i investimit synon të transformojë pronat shtetërore që shfaqin aktualisht shenja amortizimi, degradimi dhe infrastrukturë të vjetruar, jobashkëkohore dhe ku kushtet ekzistuese tregojnë nevojën për të përmirësuar cilësinë e tyre. Interesi publik që ndjek Projekti i investimit konsiston në përmirësimin e infrastrukturës sportive në vend, si dhe në energjezimin e qytetit, duke sjellë zhvillimin e zonave urbane ku ndodhen pronat. Projekti realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit dhe ndërmjetësuesit midis institucionit publik që ka interes të zhvillojë pronat e tij dhe të përfitojë prona të përmirësuara dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe kapacitetet ekzekutive dhe ka interes në realizimin e Projektit të investimit.

4. Partneri privat siguron përfitueshmëri të investimit të kryer, duke shmangur çdo burokraci dhe paqartësi në lidhje me statusin e pronës, në marrjen e lejeve, si dhe në çdo marrëdhënie me autoritetet publike. Ai, gjithashtu, në bashkëpunim me Korporatën, ndihmon në realizimin e qëllimit publik të këtij Projekti investimi.

5. Korporata nëpërmjet kësaj procedure konkurruese publike ndërkombëtare synon të përzgjedhë partnerin privat, në cilësinë e sipërmarrësit për zhvillimin e pronës për sipërmarrje, duke realizuar projektidenë arkitekturore të bashkimit të subjekteve “CEBRA | ARUP | UNO Architects”.

6. Subjekti që do të hartojë projektet e zbatimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit është përzgjedhur me një konkurs projektimi dhe njihet si “Nënkontraktor i emëruar” nga Korporata, në përputhje me përcaktimet për “Nënkontraktorët e emëruar” në “Udhëzimet për aplikantët” në “Dokumentin e kualifikimit”. “Nënkontraktorët e emëruar” për Projektin jepen në seksionin IV, nënseksioni 4, “Nënkontraktorët e emëruar” të “Dokumentit të kualifikimit”.

7. Procedura e konkurrimit për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse konkurruese me zarf, me dy faza, përkatësisht: faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në “Rregulloren e procedurave konkurruese”, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës: [link](#). Procedura është e hapur për të gjitha subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendës apo të huaj.

8. Ky “Njoftim i procedurës konkurruese” hap fazën e parë të konkurrimit për përzgjedhjen e partnerit privat. Kualifikohen në këtë procedurë konkurrimi aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe marrin përsipër angazhimet e përcaktuara në “Dokumentin e kualifikimit”. “Dokumenti i Kualifikimit” hartohet në gjuhët shqip dhe anglisht dhe publikohet në faqen e internetit të Korporatës: [link](#).

9. Në fazën e parë, kandidatët, përveç plotësimit të kriterëve të kualifikimit, duhet të marrin përsipër përmbushjen e angazhimeve /kushteve, si më poshtë:

a) angazhimin për pagesën e vlerës së hartimit të Projektit të zbatimit dhe dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit, bazuar në projektidenë arkitekturore fituese të konkursit, e



cila nuk mund të jetë më shumë se vlera e deklaruar nga projektuesi (vlera jepet nga Korporata sipas kërkesës);

b) angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;

c) angazhimin për regjistrimin e pronës së re dhe kalimin e pjesëve takuese të Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;

d) angazhimin e lidhjes së kontratës me “Nënkontraktorët e emëruar” nga Korporata, për detajimin e projektidesë arkitekture dhe përgatitjen e projektzbatimit dhe dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit, sipas projektidesë arkitekture të dhënë në këtë procedurë;

e) angazhimin që me kërkesë të Korporatës nga pjesa takuese e Korporatës në objektet e ndërtuara në pronën shtetërore, të zhvillohet plotësisht projektideja arkitekture e stadiumit “Skënderbeu” Korçë dhe rikualifikimi i zonës përreth;

f) angazhimi për të lidhur me Korporatën kontratën e sipërmarrjes dhe marrëveshjeve shoqëruese të saj dhe mbulimin e shpenzimeve të lidhjes së saj (vlera jepet nga Korporata sipas kërkesës).

Këto angazhime përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes, mospërmbyshja e të cilave sjell pavlefshmërinë e kontratës.

10. Faza e dytë e konkurrimit do t’u njoftohet vetëm kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë nëpërmjet dërgimit të “Ftesës për ofertë”. Ofertat e paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është **38% (tridhjetë e tetë për qind)** dhe do të vlerësohet me kriterin përzgjedhës, i cili është:

a) përqindja më e lartë e sipërfaqes së ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë, të përllogaritur mbi sipërfaqen totale të metrave katrorë të zhvilluar në pronën shtetërore (prona e Bashkisë Korçë dhe prona shtet).

Shpallet fituese oferta që ofron vlerën më të lartë të kësaj përqindjeje.

11. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00, ora lokale.

12. Aplikimet mund të përgatiten dhe të dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht, duhet të përkthehen në njërën nga këto gjuhë.

13. Aplikimet mund të dorëzohen me *e-mail*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **30 shtator 2025, ora 15:00, ora lokale**.

14. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, 5, Sky Tower 7/1, Tiranë, Shqipëri

E-mail: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

Notice of the Competition Procedure

Developer of Investment Project:	Albanian Investment Corporation
Name of Investment Project:	Revitalization of the “Skënderbeu” Stadium in Korça city and the requalification of the surrounding area
Contract Title:	Development of the “Skënderbeu” Stadium in Korça city and the requalification of the surrounding area, through entrepreneurship

1. The Albanian Investment Corporation, here “Corporate” is a joint-stock commercial company entirely owned by the state, with the Ministry responsible for the economy of the Republic of Albania as its sole shareholder.

2. The Corporation is implementing the investment project “Development and Management of State Properties”, which includes the sub-project “Revitalization of the “Skënderbeu” Stadium in Korça city and the requalification of the surrounding area” (hereinafter referred to as “the project”), through the legal instrument of entrepreneurship in relation to certain public properties that will be allocated for development, as specified in Section IV, Subsection 2, Property Information, of the Qualification Document.



3. The investment project aims to transform state-owned properties that currently show signs of wear, degradation, and outdated, non-contemporary infrastructure, where existing conditions indicate the need to improve their quality. The public interest pursued by the investment project lies in enhancing the country's sports infrastructure and energizing the city by fostering the development of urban areas where the properties are located. The project is implemented through a partnership model, where the Corporation acts as the developer and intermediary between the public institution that seeks to develop its properties and benefit from improved assets, and the private partner, who possesses the financial, human, and executive resources and has a vested interest in carrying out the investment project.

4. The private partner ensures the profitability of the investment made by avoiding any bureaucracy and ambiguity regarding the property's status, the acquisition of permits, as well as any interaction with public authorities. In collaboration with the Corporation, the private partner also contributes to achieving the public objective of this investment project.

5. Through this international public competitive procedure, the Corporation aims to select a private partner, in the role of the Entrepreneur for the development of the property through entrepreneurship, by implementing the architectural concept proposed by the consortium "CEBRA | ARUP | UNO Architects".

6. The entity responsible for drafting the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit has been selected through a design competition and is recognized as the "Designated Subcontractor" by the Corporation, in accordance with the provisions regarding "Designated Subcontractors" in the Guidelines for Applicants within the Qualification Document. The "Designated Subcontractors" for the project are listed in Section IV, Subsection 4, Designated Subcontractors, of the Qualification Document.

7. The competition procedure for the selection of the Private Partner will be carried out through the competitive selection procedure with envelope, with two stages, namely the qualification stage and the selection stage, as specified in the "Regulations for the Competition Procedure", published on the

official website of Corporation: [link](#). The procedure is open to all subjects, natural or legal persons, private or public, domestic or foreign.

8. This Notice of the Competitive Procedure opens the first stage of the competition for the selection of the Private Partner. Applicants who meet the qualification criteria and undertake the commitments defined in the "Qualification Document" are qualified in this competition procedure. The "Qualification Document" is drawn up in Albanian and English and published on the Corporation's website: [link](#).

9. In the first phase, qualified candidates, in addition to meeting the qualification criteria, must commit to fulfilling the following commitments:

a) the commitment to pay the cost for drafting the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit, based on the winning architectural concept of the competition, which shall not exceed the amount declared by the designer (the value will be provided by the Corporation upon request);

b) the commitment to pay the cost of taxes, fees, and contributions related to the application for development permits, construction permits, supervision of works, or any phase of the property's development up to the registration of the developed property;

c) the commitment to register the new property and to transfer the Corporation's respective share, at the expense of the private partner;

d) the commitment to enter into contracts with the "Designated Subcontractors" appointed by the Corporation, for the detailing of the architectural concept and the preparation of the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit, according to the architectural concept provided in this procedure;

e) the commitment that, upon the Corporation's request, the architectural concept for the new revitalized "Skënderbeu" Stadium in Korça city and the requalification of the surrounding area will be fully developed from the Corporation's share in the constructed facilities on the state-owned property;

f) the commitment to enter into the entrepreneurship contract and its accompanying agreements with the Corporation, and to cover the expenses related to their execution (the amount will be provided by the Corporation upon request).



These commitments constitute the preliminary conditions of the business contract, the non-fulfillment of which leads to the invalidity of the contract.

10. The second phase of the competition will be announced only to the candidates qualified in the first phase through the Invitation to Offer. The offers submitted by the candidates in this phase must meet the basic criterion, which is **38% (thirty eight percent)** and will be evaluated with the selection criterion, which is:

a) the highest percentage of the area offered to the Corporation based on the basic criterion, calculated over the total square meters developed on the state-owned property (property of the Municipality of Korça and state property).

The offer that offers the highest percentage is declared the winner.

11. Interested parties may obtain further information from the Corporation at the address provided below during business days between 09:00 and 17:00, local time.

12. Applications can be prepared and submitted in Albanian or English. Any accompanying documents that are in languages other than Albanian or English must be translated into one of these languages.

13. Applications may be delivered by *e-mail* by hand or by post to the address below **not later than September 30, 2025, at 15:00 local time**.

14. The opening of applications will take place immediately after the submission deadline at the following address:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

NJOFTIM

Nr. 393/4, datë 24.7.2025

PËR PROCEDURËN KONKURRUESE “ZHVILLIMI NËPËRMJET SIPËRMARRJES I STADIUMIT ‘FLAMURTARI’ VLORE, RINDËRTIMIT/ RIKONCEPTIMIT TË PISHINËS DHE TË PALLATIT TË SPORTIT, SI DHE RIKUALIFIKIMIT TË ZONËS PËRRETH”

**Zhvilluesi i Projektit
të Investimit:
Emri i Projektit të
Investimit:**

Korporata e Investimeve
Shqiptare
Rijetëzimi i stadiumit
“Flamurtari” Vlorë,
rindërtimi/rikonceptimi i
pishinës dhe i pallatit të
sportit, si dhe rikualifikimi i
zonës përreth
Titulli i kontratës:
Zhvillimi nëpërmjet
sipërmarrjes i stadiumit
“Flamurtari” Vlorë,
rindërtimit/rikonceptimit
të pishinës dhe të pallatit të
sportit, si dhe rikualifikimit
të zonës përreth

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata zhvillon projektin e investimit “Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore”, pjesë e të cilit është nënprojekti “Rijetëzimi i stadiumit ‘Flamurtari’ Vlorë, rindërtimi/rikonceptimi i pishinës dhe i pallatit të sportit, si dhe rikualifikimi i zonës përreth” (këtu “Projekti”), nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes lidhur me disa prona publike, të cilat do të jepen për zhvillim, të përcaktuara në seksionin IV, nënseksioni 2, “Informacioni për pronën”, të “Dokumentit të kualifikimit”.

3. Projekti i investimit synon të transformojë pronat shtetërore që shfaqin aktualisht shenja amortizimi, degradimi dhe infrastrukturë të vjetruar, jobashkëkohore dhe ku kushtet ekzistuese tregojnë nevojën për të përmirësuar cilësinë e tyre. Interesi publik që ndjek Projekti i investimit konsiston në përmirësimin e infrastrukturës sportive në vend, si dhe në energjizimin e qytetit, duke sjellë zhvillimin



e zonave urbane ku ndodhen pronat. Projekti realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit dhe ndërmjetësuesit midis institucionit publik që ka interes të zhvillojë pronat e tij dhe të përfitojë prona të përmirësuara dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe kapacitetet ekzekutive dhe ka interes në realizimin e Projektit të investimit.

4. Partneri privat siguron përfitueshmëri të investimit të kryer, duke shmangur çdo burokraci dhe paqartësi, në lidhje me statusin e pronës, në marrjen e lejeve, si dhe në çdo marrëdhënie me autoritetet publike. Ai, gjithashtu, në bashkëpunim me Korporatën, ndihmon në realizimin e qëllimit publik të këtij Projekti investimi.

5. Korporata nëpërmjet kësaj procedure konkurruese publike ndërkombëtare synon të përzgjedhë partnerin privat, në cilësinë e sipërmarrësit për zhvillimin e pronës për sipërmarrje, duke realizuar projektidenë arkitekturore të bashkimit të subjekteve “XDGA | Consulting and Management Albania Ltd | Jeshile Landscape | Bollinger + Grohmann Sarl | Ledia Kostandini”.

6. Subjekti që do të hartojë projektet e zbatimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit është përzgjedhur me një konkurs projektimi dhe njihet si “Nënkontraktor i emëruar” nga Korporata, në përputhje me përcaktimet për “Nënkontraktorët e emëruar” në “Udhëzimet për aplikantët” në “Dokumentin e kualifikimit”. “Nënkontraktorët e emëruar” për Projektin jepen në seksionin IV, nënseksioni 4, “Nënkontraktorët e emëruar” të “Dokumentit të kualifikimit”.

7. Procedura e konkurrimit për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse konkurruese me zarf, me dy faza, përkatësisht: faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në “Rregulloren e procedurave konkurruese”, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës: [link](#). Procedura është e hapur për të gjitha subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendës apo të huaj.

8. Ky “Njoftim i procedurës konkurruese” hap fazën e parë të konkurrimit për përzgjedhjen e partnerit privat. Kualifikohen në këtë procedurë konkurrimi aplikantët, të cilët plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe marrin përsipër angazhimet e përcaktuara në “Dokumentin e kualifikimit”. “Dokumenti i Kualifikimit” hartohet në gjuhët

shqip dhe anglisht dhe publikohet në faqen e internetit të Korporatës: [link](#).

9. Në fazën e parë, kandidatët, përveç plotësimit të kriterëve të kualifikimit, duhet të marrin përsipër përmbushjen e angazhimeve /kushteve, si më poshtë:

a) angazhimin për pagesën e vlerës së hartimit të Projektit të zbatimit dhe dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit, bazuar në projektidenë arkitekturore fituese të konkursit, e cila nuk mund të jetë më shumë se vlera e deklaruar nga projektuesi (vlera jepet nga Korporata sipas kërkesës);

b) angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;

c) angazhimin për regjistrimin e pronës së re dhe kalimin e pjesëve takuese të Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;

d) angazhimin e lidhjes së kontratës me “Nënkontraktorët e emëruar” nga Korporata, për detajimin e projektidesë arkitekturore dhe përgatitjen e projektzbatimit dhe dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit, sipas projektidesë arkitekturore të dhënë në këtë procedurë;

e) angazhimin që me kërkesë të Korporatës nga pjesa takuese e Korporatës në objektet e ndërtuar në pronën shtetërore, të zhvillohet plotësisht projektideja arkitekturore e stadiumit “Flamurtari” Vlorë, rindërtimi/rikonceptimi i pishinës dhe pallatit të sportit, si dhe rikualifikimi i zonës përreth;

f) angazhimi për të lidhur me Korporatën kontratën e sipërmarrjes dhe marrëveshjeve shoqëruese të saj dhe mbulimin e shpenzimeve të lidhjes së saj (vlera jepet nga Korporata sipas kërkesës).

Këto angazhime përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes, mospërmbushja e të cilave sjell pavlefshmërinë e kontratës.

10. Faza e dytë e konkurrimit do t’u njoftohet vetëm kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë nëpërmjet dërgimit të “Ftesës për ofertë”. Ofertat e paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është **45% (dyzet e pesë për qind)** dhe do të vlerësohet me kriterin përzgjedhës, i cili është:



a) përqindja më e lartë e sipërfaqes së ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë, të përlogaritur mbi sipërfaqen totale të metrave katrorë të zhvilluar në pronën shtetërore (prona e Bashkisë Vlorë dhe prona shtet/prona e Korporatës).

Shpallet fituese oferta që ofron vlerën më të lartë të kësaj përqindje.

11. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00, ora lokale.

12. Aplikimet mund të përgatiten dhe dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht duhet të përkthehen në njërin nga këto gjuhë.

13. Aplikimet mund të dorëzohen me *e-mail*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **30 shtator 2025, ora 13:00, ora lokale**.

14. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, 5, Sky Tower 7/1, Tiranë, Shqipëri

E-mail: competition@aicorporation.al;

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

Notice of the Competition Procedure

Developer of Investment Project:	Albanian Investment Corporation
Name of Investment Project:	Revitalization of the “Flamurtari” Stadium in Vloa city, reconstruction/reconception of the pool and sports palace, and the requalification of the surrounding area
Contract Title:	Development of the “Flamurtari” Stadium in Vloa city, reconstruction/reconception of the pool and Sports palace, and the requalification of the surrounding area, through entrepreneurship

1. The Albanian Investment Corporation, here “Corporate” is a joint-stock commercial company entirely owned by the state, with the Ministry responsible for the economy of the Republic of Albania as its sole shareholder.

2. The Corporation is implementing the investment project “Development and Management of State Properties”, which includes the sub-project “Revitalization of the “Flamurtari” Stadium in Vloa city, reconstruction/reconception of the pool and sports palace, and the requalification of the surrounding area” (hereinafter referred to as “the project”), through the legal instrument of entrepreneurship in relation to certain public properties that will be allocated for development, as specified in Section IV, Subsection 2, Property Information, of the Qualification Document.

3. The investment project aims to transform state-owned properties that currently show signs of wear, degradation, and outdated, non-contemporary infrastructure, where existing conditions indicate the need to improve their quality. The public interest pursued by the investment project lies in enhancing the country’s sports infrastructure and energizing the city by fostering the development of urban areas where the properties are located. The project is implemented through a partnership model, where the Corporation acts as the developer and intermediary between the public institution that seeks to develop its properties and benefit from improved assets, and the private partner, who possesses the financial, human, and executive resources and has a vested interest in carrying out the investment project.

4. The private partner ensures the profitability of the investment made by avoiding any bureaucracy and ambiguity regarding the property’s status, the acquisition of permits, as well as any interaction with public authorities. In collaboration with the Corporation, the private partner also contributes to achieving the public objective of this investment project.

5. Through this international public competitive procedure, the Corporation aims to select a private partner, in the role of the Entrepreneur for the development of the property through entrepreneurship, by implementing the architectural concept proposed by the consortium “XDGA | Consulting and Management Albania Ltd | Jeshile



Landscape | Bollinger + Grohmann Sarl | Ledia Kostandini”.

6. The entity responsible for drafting the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit has been selected through a design competition and is recognized as the “Designated Subcontractor” by the Corporation, in accordance with the provisions regarding “Designated Subcontractors” in the Guidelines for Applicants within the Qualification Document. The “Designated Subcontractors” for the project are listed in Section IV, Subsection 4, Designated Subcontractors, of the Qualification Document.

7. The competition procedure for the selection of the Private Partner will be carried out through the competitive selection procedure with envelope, with two stages, namely the qualification stage and the selection stage, as specified in the “Regulations for the Competition Procedure”, published on the official website of Corporation: [link](#). The procedure is open to all subjects, natural or legal persons, private or public, domestic or foreign.

8. This Notice of the Competitive Procedure opens the first stage of the competition for the selection of the Private Partner. Applicants who meet the qualification criteria and undertake the commitments defined in the “Qualification Document” are qualified in this competition procedure. The “Qualification Document” is drawn up in Albanian and English and published on the Corporation’s website: [link](#).

9. In the first phase, qualified candidates, in addition to meeting the qualification criteria, must commit to fulfilling the following commitments:

a) the commitment to pay the cost for drafting the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit, based on the winning architectural concept of the competition, which shall not exceed the amount declared by the designer (the value will be provided by the Corporation upon request);

b) the commitment to pay the cost of taxes, fees, and contributions related to the application for development permits, construction permits, supervision of works, or any phase of the property’s development up to the registration of the developed property;

c) the commitment to register the new property and to transfer the Corporation’s respective share, at the expense of the private partner;

d) the commitment to enter into contracts with the “Designated Subcontractors” appointed by the Corporation, for the detailing of the architectural concept and the preparation of the detailed design and the necessary documentation required to obtain the construction permit, according to the architectural concept provided in this procedure;

e) the commitment that, upon the Corporation’s request, the architectural concept for the new revitalized “Flamurtari” Stadium in Vlora city, reconstruction/reconception of the pool and sports palace, and the requalification of the surrounding area will be fully developed from the Corporation’s share in the constructed facilities on the state-owned property;

f) the commitment to enter into the entrepreneurship contract and its accompanying agreements with the Corporation, and to cover the expenses related to their execution (the amount will be provided by the Corporation upon request).

These commitments constitute the preliminary conditions of the business contract, the non-fulfillment of which leads to the invalidity of the contract.

10. The second phase of the competition will be announced only to the candidates qualified in the first phase through the Invitation to Offer. The offers submitted by the candidates in this phase must meet the basic criterion, which is **45% (forty-five percent)** and will be evaluated with the selection criterion, which is:

a) the highest percentage of the area offered to the Corporation based on the basic criterion, calculated over the total square meters developed on the state-owned property (property of the Municipality of Vlora and State property /Corporation property).

The offer that offers the highest percentage is declared the winner.

11. Interested parties may obtain further information from the Corporation at the address provided below during business days between 09:00 and 17:00, local time.

12. Applications can be prepared and submitted in Albanian or English. Any accompanying documents that are in languages other than



Albanian or English must be translated into one of these languages.

13. Applications may be delivered by *e-mail* by hand or by post to the address below **not later than September 30, 2025, at 13:00 local time.**

14. The opening of applications will take place immediately after the submission deadline at the following address:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al;

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>

URDHËR

Nr. 375, datë 29.7.2025

PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË ANËTARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe të pikës 7 të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet

dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit do të jetë deri më datë 13.8.2025.

4. Publikimi i kriterëve dhe i procedurave që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA NR. 1

NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe urdhrit nr. 375, datë 29.7.2025, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit,



përfaqësues i MAS-it në institucionet publike të arsimit të lartë, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për bord administrimi
1	Universiteti i Mjekësisë Tiranë	-1 anëtar përfaqësues i MAS-it
2	Universiteti Politeknik i Tiranës	-1 anëtar përfaqësues i MAS-it

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;

- Me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

- Me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

- Me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

- Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- Miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- Jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- Është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- Emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- Miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë shtetas shqiptar;

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- Të ketë integritet etik dhe profesional;

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;



- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi;

- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj;

- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;

- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- Kërkesë për aplikim;

- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV – *Curriculum Vitae*);

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”) për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe njësimi të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- Fotokopje të librezës së punës;

- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;

- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të jetë deri më datë 13.8.2025 në një nga këto mënyra:

a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc*, të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit kryhet nga një komision *ad-hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatin e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Bordin e Administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pese mijë) lekë në muaj.



SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar Bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrim _____

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

